



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut , Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Prishtinë me 6 mars 2008 në orën 13,00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V R B A L

**i mbledhjes se Komisionit për të Drejtat e Njeriut ,Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Në mbledhje morën pjesë : Ismet Beqiri, kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Nerxhivane Dauti, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu dhe Ibrahim Makolli, anëtarë.

Nga të ftuarit ,në mbledhje mori pjesë:
z. Luigj Ndau nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e
Zhdukur kurse nuk iu përgjigjën ftese z. Pajazit Nushi dhe Flora Brovina

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri -kryetar dhe propozoi këtë ;

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar,
2. Takim pune me përfaqësuesin e Komisionit Ndërkombëtar për personat e Zhdukur , Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur z. Pajazit Nushi dhe Flora Brovina .
3. Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua .

U hap shqyrtimi për pikën e parë.

1 Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Pasi nuk pati vërejtje ai u miratua.

2. Takim pune me përfaqësuesin e Komisionit Ndërkombëtar për personat e Zhdukur , Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur z. Pajazit Nushi dhe Flora Brovina

Ismet Beqiri, kryetar pasi i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe u dëshiroi mirëseardhje, shtoi : Në vazhden e takimeve, që do të kemi, do të ftojme përgjegjësit e fushave që i mbulohen nga Komisioni dhe lidhur me këtë hap debatin.

Luigj Ndou- ne fillim i njoftoi anëtarët me punë që ka bërë Komisioni Ndërkombëtarë për Personat e Zhdukur që nga viti 1999 deri me tani. Ai shtoi : Komisioni punon me të gjitha komunitet dhe se qëllimi është për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur në konfliktin e armatosur në Kosovë .

Me tutje , ceku se ICMP-ja ka ofruar ndihem teknike shoqatave që merren me personat e pagjetur ,të cilave iu ka ofruar 55 projekte financiare. Me këtë rast, ceku se ISMP-ja ka bërë mbledhjen e mostrave të gjakut anëtareve të personave të familjeve të zhdukura dhe, mjerisht, ky proces nuk ka përfunduar. Prandaj, preokupim mbetet identifikimi i lokacioneve të reja të trupave pa jetë të cilat gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë. Ndërsa , lidhur me identifikimet e gabueshme, të cilat janë bërë para se të bëhen analizat e ADN-së, sipas tij ,kjo ka ndodh pa fajin e Komisionit, gjë që ka krijuar pakënaqësi të familjaret në zhvarrosjet e serishme . Komisioni ka mundësi t'u ofrojë ekspert në hartimin e Projektligjit për personat e pagjetur. Në fund ceku kontaktet që ka zhvillu Komisioni Ndërkombëtar me shoqatat për personat e zhdukur të mbajtura në Ohër si dhe me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur.

Luljeta Shehu – duke ndërlidhur me diskutimin e parafolësit shtroi : Lidhur me personat e pagjetur nga Krusha e Madhe, i njoftoi të pranishmit se disa herë iu janë marrë mostrat e gjakut familjeve,prandaj nëse serish kërkohet marrja e gjakut, do të krijojmë pakënaqësi tek qytetaret dhe veprimi nuk e arsyetohet. Ajo e ngriti çështjen e varrimeve me dy - tri pjesë eshtrash dhe sjellja eshtrave tjerë po krijon skena të pakëndshme të familjet që kanë të zhdukur të dashurit e tyre dhe pyeti: çka do të behet me kockat e ofruara?

Sanije Alijaj –duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi :Projektligji për personat e zhdukur a do t'ua rregullojë statusin këtyre personave ? Ne këtë kontekst, ceku se disa familje nuk dëshirojnë të shpallin si të zhdukur të afërmit e tyre dhe pyeti : A do të përfshihet në ligj kjo kategori e personave deri sa të behet identifikimi i tyre? Në fund u interesua për punën e Komisionit Ndërkombëtar në identifikimin 240 mbetje mortore të personave të pagjetur në Suharekë dhe pyeti: Pse po zvarritet procesi i çështjes së identifikimit të 450 kufomave në Prishtinë.

Radmilla Vujoviç-kërkoi informatë lidhur me mysafirin se nga i cili rejon të Kosoves vie. Ajo vuri në pah: Komisioni si në legjislaturën e mëparshme por edhe ky, kanë përgjegjësi në zbardhjen e personave të pagjetur dhe se ky proces do të zgjatë edhe në të ardhmen. Me tutje, nënvizoi : Pasi nga parafolësi u zu ngoje Bosnja ,unë do të thosha se në Qipro mëse 40 vite ka zgjatë procesi i indetentifikimit . Ajo kërkoi që statusi i këtyre familjeve të rregullohet me ligj dhe familjet të vizitohen nga ana e Komisionit .

Ibrahim Makolli – duke u ndërlidhur me parafolësin shprehu shqetësimin e termit të “konfliktit të arnotusur “nga se në Kosovë ka pasur luftë . Me tutje ceku se shifra prej 1800 personave prej të cilëve 800 sish janë agjësuar nga zyrtaret e OSBE-së dhe prej tyre kishte nga Ukraina dhe Rumania. Komisionit i propozoi të përcjell gjendjen dhe këto familje të vizitohen.

Nerxhivane Dauti – duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi: Kjo fushë është e ndjeshme dhe ka nevojë që kjo të rregullohet me ligj të veçanët dhe për ndihma që na ofrohet me ekspertë, ne e falënderojmë ngase do të japin kontributin si ekspertë edhe pse ne ligjslaturen e parë dhe të dytë kam dhënë kontribut në hartimin e ligjeve fundamentale. Ajo kërkoi për një bashkëpunim të ngushtë në mes komisioneve .

Pyetjeve të deputeteve iu përgjigje z. Luigj Ndou ,të cilat i mirëpritën.

Ismet Beqiri kryetar, kërkoi nga Qeveria e Kosovës informatë lidhur me përfshirjen në kornizën legjislative të Projektligjit për familjet e personave të pagjetur dhe njëkohësisht kërkoi nga Qeveria e Kosovës të kompletojë Komisionin për Personat e Zhdukur duke mbështetur bashkëpunimin me ICMP-n.

Ishte një konstatim i përgjithshëm lidhur me dyshimin e kufomave në Republikën e Maqedonisë dhe lidhur me këtë Komisioni nxori :

P ë r f u n d i m

- *Komisioni kërkon nga Qeveria e Kosovës që serish të ripërsërisë kërkesën e cila ka të bëjë me zbardhjen e fatit të personave të pagjetur për të cilët dyshohet se janë të varrosur në territorin e shtetit të Maqedonisë.*

3. Të ndryshme

Komisioni debatoi lidhur me formën e zgjidhjes së peticioneve dhe u mor qëndrim se në çdo mbledhje t’i duhet t’i këtë disa sosh për shqyrtim .

Pastaj, u diskutua lidhur me vizitat që do t’i këtë dhe mënyra e organizimit të tyre .

Mbledhja përfundoi në orën 14 ,30

Procesverbalin e hartoi
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri